



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr. 1024/prot
18

Datë, 15/05/2019

VENDIM
Nr. 3 datë 2/5/2019

PËR
RRËZIMIN E PROPOZIMI PËR MIRATIMIN E LEJES " PËR HAPJEN E NJË PUS-SHPIMI", NJËSIA BASHKIAKE NR. 5, BASHKIA TIRANË, PËR SUBJEKTIN "J.A.M CONSTRUCTIONS" SH.P.K

Në zbatim të Ligjit Nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të ndryshuar, përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2, vendimit nr. 416 datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", vendimit nr.221 datë 26.04.2018 "Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore" paragrafi III, pika 5 gërma "i", vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" neni 16 gërma "ç", Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen (KBU),

KONSTATOI SE;

- Nga shqyrtimi i kërkesës së subjektit "J.A.M CONSTRUCTIONS" shpk, për hapjen e një pus-shpimi" me vendodhje afër kompleksit Dinamo, njësia Bashkiake nr.5 Tiranë, bazuar në diskutimet e anëtarit të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm Erzen, përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë u shpreh për rrëzimin e propozimit të ZABU-së, deri në një qëndrim zyrtar të Bashkisë Tiranë për problematikën e lavazheve. Nga diskutimet e anëtarëve u kërkua që Bashkia të japi argumentat ligjor në lidhje me problematikën e lavazheve në bashkinë Tiranë.

Përsa më sipër KBU Ishëm-Erzen,

V E N D O S I :

1. Rrëzimin e propozimit për miratimin e lejes për hapjen e një pus shpimi për ujë teknologjik, për subjektin "J.A.M CONSTRUCTIONS"sh.p.k. me vendodhje afër kompleksit "Dinamo", Njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë, me këto të dhëna:
 - Koordinatat në KRGJSH të pusit të projektuar: X=483984.01, Y=4575274.78, Z=121 m
 - Kapaciteti i parashikuar 0.5 l/s

- Thellësia e shpimit të pusit 250 m
 - Diametri i shpimit të pusit Ø250 mm
 - Qëllimi i përdorimit: Ujë teknologjik
- Ky propozim rrëzohet për arsye të mëposhtme:
- Paraqitja zyrtarisht nga ana e Bashkisë Tiranë e argumentimit ligjor për problematikën që hasin me lavazhet.
- Rishikimi i raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
3. Ngarkohet ZABU Ishëm-Erzen-Mat për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi
4. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR

Adrian SHTINO



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

